

V E N D I M
Nr.426, datë 11.6.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE TË PUNONJËSVE
MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, lidhja nr.2, lidhja nr.3 “Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar që punojnë larg vendbanimit” zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA NR.1
STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË

EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E PROFESIONIT	
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHK)	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP)	Totali
Drejtor i shkollës së mesme Përgjegjës poligoni Drejtor Ins.të Nxën. që nuk shikojnë Drejtor Inst. të Nxën, që nuk dëgjojnë Drejtor në shkolla me PLM Drejtor i konvikteve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	10 273 lekë	Nga ... lekë Deri...lekë
Zv/Drej. në shkollë të mesme Drej.i Shkollës 8-vjeçare Zv./Dr. në Inst. e Nx. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM. Drej. i Qendrës.Kult. të Fëmijëve Përgjegjës i bazës prodhuese	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	9 020 lekë	Nga ...lekë Deri...në lekë
Drej. i shkollës fillore (klasa e i-IV) Përgj. (kryemësues) i shk. me klasë kolektive Zv/Drej. i shk. 8-vjeçare Përgj. sekt. në Qend. Kult.Fem	1	“	“	7 837 lekë	Nga...lekë Deri ...lekë
Dr. i kopshtit me ushqim	1	“	“	6 850 lekë	“
Dr. i kopshtit pa ushqim	1	“	“	5 702 lekë	
Mësues në shkollat e mesme					
Mësues në Shk.së Ulët Profesionale				7 214 lekë	Nga...lekë Deri ...lekë

Mësues në Inst. e Nx që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe Shk. me PLM	1	“	“		
Mësues në Shk.8-vjeçare (I-VIII) Edukatore konvikti Kujdestar konvikti Instruktur në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	“	“	6 292 lekë	Nga...lekë Deri ...lekë
Edukatore në Kop.fëmijësh	1	“	“	5 192 lekë	Nga...lekë Deri ...lekë
Mësues në shk. të mes. dhe 8-vjeçare	3	“	“	6 292 lekë	“
Edukator në kop.fëmijësh	3	“	“	5 192 lekë	

LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1.	9 000 lekë
2.	8 000 lekë
3.	6 000 lekë
4.	3 600 lekë

LIDHJA NR.3

SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim si vijon:

Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, deri në 1152 lekë; kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, deri në 3456 lekë.

Kur punojnë jashtë rrethit të tyre, në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, deri në 4611 lekë kur punojnë në qytetet dhe në qendër të rrethit dhe deri në 5756 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, deri në 3456 lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër dhe deri 4611 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera deri në 2300 lekë kur punojnë në qytetet dhe në qendrën e rrethit dhe deri 3456 lekë kur punojnë jashtë qytetit e qendrës së rrethit.